



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin

№ 56 Piset
13.05.2018

VENDIM

Nr. 44/2 datë 13.05 2018

“Për

Miratimin e kërkesës së subjektit “Kurum International” Sh.A” për marrje “Leje për përdorimin pus – shpimi ,” Pusi nr. 4” ,“Ujë për qëllime higjeno – sanitare ”, bashkia Elbasan.

Në zbatim të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 5 pika 2, neni 12 pika 2, neni 50 pika 2, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë, 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 5 datë, 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6. datë 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës së subjektit “Kurum International” Sh.A” për marrje “Leje për përdorimin pus – shpimi ,” Pusi nr.4”,“Ujë për qëllime higjeno – sanitare ”, bashkia Elbasan.

Koordinatat e pusit janë :

X 45 51 506

Y 44 18 487

Z 107 m

Viti i hapjes së pusit	1999
Thellësia e pusit	48 m
Kapaciteti i pusit	1 l/s
Volumi maksimal i ujit që kërkohet për përdorim	1 m ³ /orë
Diametri i pusit	200 mm
Prurja mesatare	0.00014 m ³ /s
Prurja mesatare e muajit më të thatë	0.00014 m ³ /s
Sasia e ujit që kërkohet për përdorim	0.00014 m ³ /s

Numri i punonjësve	80
Norma e ujit për punonjës/ditë	150 l/ditë/punonjës
Numri i ditëve të punës për punonjës	25 ditë pune / punonjës

Kordinatat e pikës së shkarkimit :

X 45 51 556

Y 44 18 447

Z 105 m

Trupi ujqor pritës	Kanal shkarkues industrial
Prurja që shkarkohet	0.00014 m³/s
Volumi që shkarkohet	12 m³/ditë

Vendimi hyn në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Basenit Ujqor Shkumbin Elbasan

PËRGJEGJËS ABU

KRYETARI I KBU

SHKUMBIN

SHKUMBIN

Dashamir BIÇAKU

Maksim MALAJ

